

## Hepatitis B – vaksinimi mbronë

Në Zvicër çdo vit nga Hepatitis B infektohen dikund prej 2000 – 3000 kryesisht persona te rinjë, kunder të cilit infektim egziston qe disa vite një vaksinë me ndikim te mirë.

### Çka është Hepatitis B?

Hepatitis B është një infektim i melçisë, i cili përcjellet nëpërmjet virusve. Vëtëm njëri prej tre personave te infektuar heton shënja te dukshme te infektimit te melçisë siç është sarillaku me ngjyrosjen e verdhë (sari) te lëkurës dhe te syve, me urinë ngjyrë braun dhe me jashtëçitje me ngjyrë të çelët. Te dikund rreth 10% te personave te infektuar vije deri te infektimi kronik te melçisë.

### Çka është e rrezikshme te Hepatitis B?

Në këtë kohë janë në Zvicër dikund rreth 20.000 persona te cilët vuajn nga infektimi kronik i melçisë. Shumë nga te infektuarit me Hepatitis B nuk tregojnë shënja te dukshme të kësaj smundje. Për këtë arsye kjo smundje mund te përcjellet në mënyrë te pa hetueshme në personat tjerë.

Kur ka ardhur deri te infektimi është vonë qe te merret vaksina, dhe një mjekim te mirë për Hepatitis B ende nuk ka.

Nga sëmundja kronike hepatitis B, që dëmton plotësisht mëlqinë dhe që mund të përfundojë me kancer të mëlqisë, vdesin brenda vitit afërsisht 20-30 njerëz.

### Si vije deri te infektimi me Hepatitis B?

Virusi i Hepatitis B mund te përcjellet nepermjet të të gjithë lëngjet trupore, e posaqerisht mund te vije deri te infektimi me anë te gjakut qe konsiderohet si shumë infektues. Posaqerisht shpesh infektohet te rinjët dhe te rinjë te moshës madhore. **Mënyrat më te shpeshte te infektimit janë:**

- *mardhënjet seksuale me një person te infektuar*
- *konsumimi i narkotikëve me ineksione jo sterile*
- *tetovirimi, piersingu me mjete jo sterile*
- *kontakte te ngushta trupore me personat te infektuar*
- *gjatë lindjes, nese nëna është e infektuar*

Nuk ka rrezik për infektim, nese gjaku i infektuar bie në lëkur të shëndosh, si dhe nëpërmjet te marrjes së ushqimit ose nepermjet te pirjës (këtu fjala është për Hepatitis A).

### Si mund te mbrohem?

Qe disa vite egziston një vaksinë mbrojtse, e cila i preferohet të gjithë personave te moshës rinore prej 11 deri në 15 vite, për arsye se këtë janë moshë më e rrezikuar nga ky infektim (moshëa në mes te 20 deri në 24 vite). Vaksinimi bëhet në një period kohor prej 6 muajve dhe ate 2 herë në pjesën e siperme te dorës dhe zakonisht ka ndikim dhe mbron nga ky infektim tërë jetën.

Si pasoja jo te rrezikshme mund te çfaqen në një prej 10 personave te vaksionuar dhëmbje te vogla në vëndin ku është bërë vaksinimit. Pasoja të rënda janë shumë te rralla.

**Këshillohuni nga mjeku i jauj shtepiak ose shkollor.**

*Verziona gjerman i përpiluar nga ana e shërbimit mjekësorë shkollorë Zürich.*